

NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE TE TË RINJTË

BASHKËSIA ISLAME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
Boton: FAKULTETI I STUDIMEVE ISLAME - Prishtinë
Për botuesin: Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi

Redaktor përgjegjës:

Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi

Përgatitën për botim studentët e grupit hulumtues të FSI-së:

Enisa Bekteshi, Esra Murati, Lirigzona Pllana,
Fatime Nitaj, Artin Shala, Rineta Nitaj,
Abdullah Bahtiri, Enis Beshi

Redaktor letrar:

Prof. Dr. Hysen Matoshi

Korrektor:

Mr. Vedat Shabani

Realizimi kompjuterik:

Nuhi Simnica



NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE TE TË RINJTË

(Grupi hulumtues i studentëve
të Fakultetit të Studimeve Islame)

**Prishtinë
2021**

ABSTRAKTI

Ky është një studim i bërë lidhur me *‘Ndikimin e rrjeteve sociale te të rinjtë’*, i cili synon hulumtimin dhe identifikimin e efekteve negative që ushtrojnë rrjetet sociale te të rinjtë, krahas efekteve pozitive. Disa nga hipotezat e studimit tonë ishin se përdorimi i tepruar i rrjeteve sociale ka ndikuar edhe në zbrazjen e bibliotekave, në të cilat numri i lexuesve është i vogël, ndërkohë më i pëlqyeshëm për të riun është bërë passwordi i WI-FI-së sesa titulli i një libri “Best Seller”; po ashtu edhe qëndrimi me familjen, si pjesa më e bukur e jetës, është zëvendësuar me biseda të herëpashershme nëpërmjet telefonave të mençur, ndërsa takimet fizike me të dashurit e zemrës bëhen përmes kamerave dhe përqaftimet janë zëvendësuar me “stickers” e gjithë kjo për shkak të “dashurisë” ndaj rrjeteve sociale.

Metoda e hulumtimit, e zbatuar për të mbledhur të dhëna për këtë studim, ishte ajo empirike, ndër të cilat kemi përdorur metodën kualitative dhe kuantitative, si dhe metodat teorike, pasi që kemi shfrytëzuar libra të së njëjtës fushë si dhe studime të mëhershme lidhur me këtë temë.

Pyetësi përmbante tetë pyetje, me nga 3, 4 dhe 5 opsione.

Në këtë studim u përfshinë 1388 pjesëmarrës. Mosha e tyre ishte 13-29 vjeçe. Nga rezultati i studimit, hipoteza jonë u mbështet, sepse ata ranë dakord se ndikimi i rrjeteve sociale, si në aspektin e mosleximit, ndikimit psikik

dhe fizik, humbjes së kohës dhe moskalimit të kohës me familje e me të afërm është i pranishëm dhe po ashtu e pranishme është edhe varësia te pothuajse gjysma e atyre që kishin menduar të largoheshin nga ndikimi i rrjeteve sociale, por nuk ia kishin dalë.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	5
PËRMBAJTJA	7
1. HYRJE	9
1.1. Hyrje e përgjithshme e problemit mbi ndikimin e rrjeteve sociale	9
1.2. Konteksti i problemit	10
1.3. Rëndësia e vetëdijesimit mbi përdorimin e rrjeteve sociale	11
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	12
3. METODOLOGJIA	15
3.1. Hipotezat.....	15
3.2. Pyetjet	16
3.3. Metodologjia e përdorur për hulumtimin tonë ...	16
4. NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE TE TË RINJTË	17
4.1 Përparësitë e përdorimit të internetit	18
4.1.1 Qasja më e lehtë dhe më e shpejtë tek informimi	18
4.1.2 Interneti bashkoi njerëzit që ishin mijëra kilometra larg	18
4.2 Mangësitë që marrim nga përfitimi i tij.....	19
4.2.1 “Ftohja” e lidhjeve farefisnore	19
4.2.2. Shëndeti mendor.....	19
4.2.3. Përqendrimi	20
4.2.4. Varësia nga interneti i bën dëm trurit njësoj si droga dhe alkooli.....	20

5. DISA NGA ASPEKTET KONKRETE SE SI NDIKOJNË RRJETET SOCIALE TE TË RINJTË.....	21
5.1. Mosleximi.....	21
5.2. A mund ta quajmë lexim, leximin e statuseve nëpër rrjete sociale?	22
5.3. Ngecja në mësim/studime.....	23
5.4. Ndikimi negativ në aspektin fizik dhe psikik	26
5.5. Moskalimi i kohës së lirë me familjen e shoqërinë dhe lënia e tyre anash.....	29
6. REZULTATET DHE DISKUTIMET	36
6.1. Arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale.....	37
6.2. Koha e kaluar në rrjetet sociale si kohë e humbur.....	40
6.3. Qëndrimi i pakontrolluar në rrjete sociale	43
6.4. Varësia nga rrjetet sociale.....	46
6.5. Mosleximi si pasojë e rrjeteve sociale	49
6.6. Rrjetet më të përdorura	52
6.7. Kategoria e njerëzve me të cilët komunikojmë më së shumti nëpërmjet rrjeteve sociale	54
6.8. Ndikimi fizik dhe psikik i rrjeteve sociale.....	57
7. KRAHASIMI NDËRMJET TRI NIVELE SHKOLLORE: FILLOR, I MESËM DHE BAÇELOR	59
8. KUFIZIMET DHE REKOMANDIMET	76
9. PËRFUNDIMI.....	79
BIBLIOGRAFIA	81
APENDIKSI.....	83

1. HYRJE

1.1. Hyrje e përgjithshme e problemit mbi ndikimin e rrjeteve sociale

Përdorimi i rrjeteve sociale është bërë një shprehi e pazëvendësueshme në ditët e sotme. Ky ndikim i pavëmendshëm ka përfshirë njerëzit anembanë globit. Por edhe më problematike këtë drejtim është sjellja jonë normale karshi kësaj dukurie.

Andaj, për të arritur gjer tek një vetëdijësim mbi dominimin e kësaj gjendjeje, apo situatë, në përditshmëritë tonë, ne si studentë e kemi parë të arsyeshme ta bëjmë një hulumtim rreth kësaj problematike, e cila nuk është vetëm jona, por si e tillë përfaqëson një interes mbarëshoqëror.

Megjithatë, nuk mund ta mohojmë faktin që kjo çështje ka si dimensionin e saj si negativ ashtu edhe atë pozitiv. Madje, mund të themi se sot kemi qindra përparësi nga përparimi teknologjik që e ka bërë komunikimin më të lehtë dhe më gjithëpërfshirës, por nuk mund t'i anashkalojmë as pasojat negative që i hasim nga ndikimi i rrjeteve sociale. Andaj, në vazhdim do të kemi në fokus elaborimin e kësaj çështjeje, gjithmonë duke iu referuar metodave sa më të duhura dhe profesionale.

1.2. Konteksti i problemit

Vlen të ceket se problemi nuk qëndron te ekzistimi i rrjeteve si të tilla, por te varësia ndaj tyre, ngecja në to, apo mosekulibrimi i jetës sonë me rrjetet sociale. Duhet pasur parasysh se një varësi e tillë është problem global me të cilin po ballafaqohet pothuajse çdo shtet dhe çdo individ mbi rruzullin tokësor. Brenda kësaj çështjeje janë dhënë opinione dhe janë diskutuar tema të ndryshme, ndër to: - Cilat janë dobitë nga rrjetet sociale dhe cilat janë dëmet? (anët pozitive dhe ato negative), si ta mënjanojmë përdorimin e tepërt të këtyre rrjeteve? Dëmet fizike dhe ato psikike që na shkakton interneti? (këshilla nga mjekë dhe psikologë), shifrat e shkurorëzimeve që janë shënuar si shkak i rrjeteve sociale, nëse lajmet apo informacionet e shpejta po shkaktojnë depresion kudo në botë etj.

Shikuar nga një këndvështrim tjetër, telefonat në duart tona na kanë mbizotëruar masivisht dhe janë bërë pjesë e pandashme e jetës pa vetëdijen tonë. Mirëpo, para se ta fajësojmë veten, duhet ta shtrojmë çështjen se a kanë faj kompanitë, të cilat i kanë zbuluar telefonat e mençur të llojeve të ndryshme, e që ende po vazhdojnë të zbulojnë aplikacione të shumta që vazhdimisht po krijojnë varësi dhe me shumë mëdyshje nuk po e kuptojmë nëse janë në dobi apo në dëmin tonë?

Duhet kuptuar faktin se sot teknologjia e ka pushtuar tërë botën, njerëzit janë bërë të famshëm nëpërmjet internetit, të tjerët ndajnë politikat dhe interesat e tyre, disa janë pasuruar përmes rrjeteve sociale... Në njëfarë forme bota është bërë e paimagjinueshme pa internetin!

1.3. Rëndësia e vetëdijesimit mbi përdorimin e rrjeteve sociale

Nuk duhet mohuar fakti se interneti ka sjellë edhe disa lehtësime, e veçanërisht për studentët kur bëhet fjalë për literaturë. Ai sot luan rolin e një burimi të rëndësishëm, duke ofruar lehtësi për studentë që mund ta shkarkojnë ndonjë libër që nuk mund ta posedojnë, ose ta përdorin si literaturë gjuhëve të huaja, të marrin statistika që u nevojiten, duke krijuar mundësi hulumtimi mbi çdo kuriozitet (edhe pse ka të meta sa i përket vërtetësisë së disa burimeve).

Ndërkaq problemi qëndron në atë se sa përdorimi i rrjeteve sociale, përmes internetit, ka shkatërruar bibliotekat tona, librat e veçanërisht mendjet tona?

Ka një rol tejet negativ në këtë aspekt, sepse studentëve po u shkakton varësi, dekokentrim dhe dekujarim gjatë zhvillimit të studimeve të tyre!

Andaj është tejet e rëndësishme që të arrihet në një vetëdijesim në mënyrë që të rinjtë të kenë sa më shumë informacione mbi dobitë dhe pasojat nga ndikimi apo varësia e rrjeteve sociale në jetën tonë.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Megjithëse media sociale mund të rrisë mësimin e studentëve nëpërmjet ndërveprimit të studentëve, ka një varg sfidash.

Ja disa nga hulumtimet që janë bërë në këtë fushë:

Rezultatet tregojnë se mediat sociale luajnë rol të rëndësishëm në studim dhe në mundësi punësimi. Shumica e adoleshentëve përdorin rrjetet sociale për komunikim me shokët dhe me familjarët.

Rezultatet po ashtu tregojnë se mediat sociale shkaktojnë probleme shëndetësore dhe kanë ndikim në kulturën tonë. Gjatë përdorimit të medieve sociale, përdoruesit duhet të mbajnë mend dhe të mos harrojnë vlerat kulturore, normat e shoqërisë dhe vlerat e Islamit. Në këtë studim 380 studentë janë zgjedhur si mostër e thjeshtë drejtëpërdrejt prej 28,342 studentëve të Universitetit të Sargodha. (International Journal of English Language, Literature in Humanities, Samprathi Av, 2019)

Prej këtij studimi është nxjerrë se qind për qind e të anketuarve janë të kënaqur me shfletimin e informacioneve në internet dhe se 86 për qind e të anketuarve konsideronin se mediat sociale janë të nevojshme në fushën e edukimit dhe se kanë ndikim pozitiv dhe negativ në rininë. Mostra e rëndomtë është përdorur si metodë e këtij hulumtimi. Numri total i mostrës ishte 50 veta duke përfshirë djem dhe vajza. (International Journal of Current Research, 2017)

Mediat sociale janë metoda më e shpejtë e komunikimit, e cila ka ndikim të madh në formësimin e jetës personale dhe të mënyrës se si jetojnë të rinjtë. Edhe pse ka ndikim të madh të rinia, gjithashtu ka ndikim konkret negativ sa herë është fjala për problemet e privatësisë. Qëndrimi i plotë në rrjetet sociale do ta zvogëlojnë komunikimin sy me sy dhe në vend të kësaj na shpie drejt komunikimit kibernetik.

Studenti, i cili gjithmonë përfshihet në media sociale, ka mungesë koncentrimi në studime, në aktivitete fizike e të tjera. Studimi përfshin 200 studentë të përzgjedhur rëndom prej akademikëve institucionalë dhe përreth në qytetin e Bangalore. (Dr. George Dimitrov, Ms. Noblelyne Nongkyrih, 2017)

Shumë të rinj preferojnë të kërkojnë informacion në internet mbi seksin dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme si dhe çështje të tjera shëndetësore. Interneti nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojë ndërveprimin e njeriut, ose marrëdhëniet ndërmjet njerëzve, por as edhe të marrë vendin e aktiviteteve të tilla, si bisedat, apo leximi i përbashkët. Huluntimi është bërë me nxënësit e shkollës së mesme “Zenel Hajdini” dhe ata shkollës fillore “Selami Hallaqi” në Gjiilan.

Sipas rezultateve të huluntimit, nga 202 të anketuar në pyetjen “A e përdorni internetin” vetëm një është përgjigjur se nuk e përdorë, ndërsa 99.5 % e përdorin atë. “A ju pengon interneti në mësimë”: në opcionin **deri diku** janë

përgjigjur 87, 62 deklarojnë se nuk u pengon, ndërsa 53 pohojnë se u pengon në mësim (Ajshe Leka, 2013).

Shumica nga të rinjtë, në ndonjë fazë të caktuar, kanë përfunduar se rrjetet sociale janë duke i penguar në punë apo në mësim, ose se janë duke ndikuar negativisht në gjendjen e tyre emocionale, ose thjesht kanë konsideruar se janë duke humbur shumë kohë në to dhe i kanë mbyllur.

Një e katërta e të anketuarve në Prishtinë shprehen të jenë lidhur në internet në nivel romantik me dikë që nuk e kanë takuar në jetën reale. Ky projekt hulumtues u realizua duke përdorur metodologjinë e kërkimeve kuantitative. Hulumtimi u realizua në Komunën e Prishtinës. Në hulumtim janë përfshirë 450 respondentë nga mosha 15 deri në 27 vjeç. (Instituti Gnosis, 2017)

Këto janë disa nga hulumtimet e viteve të fundit, që janë bërë për ndikimin e rrjeteve sociale te të rinjtë. Konkluzionet e këtyre hulumtimeve janë të ndryshme, por rezultat i përbashkët i të gjithave, në fund, është se të rinjtë kudo në botë, pra edhe në Kosovë, janë të ndikuar nga rrjetet sociale në fusha të ndryshme të jetës. Edhe hulumtimi ynë ka për qëllim studimin e kësaj çështje te të rinjtë kosovarë, se sa janë të ndikuar ata nga mediat sociale, dhe cilat kanë efektet negative të tyre.

3. METODOLOGJIA

3.1. Hipotezat

- Nëse rrjetet sociale janë duke ndikuar jashtëzakonisht në humbjen e kohës së studimit të rinjtë, atëherë del se të rinjtë, si pjesa më produktive e shoqërisë, janë pasivizuar duke u marrë me gjëra të cilat ua humbin kohën pa qenë gjithaq të vetëdijshëm për një gjë të tillë.
- Mendojmë se përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale ka ndikuar edhe në zbrazjen e bibliotekave, në të cilat numri i lexuesve është i vogël, ndërkohë më i dashur për të riun është bërë passwordi i WI-FI-së sesa titulli i një libri “Best Seller”.
- Mendojmë se qëndrimi bashkë me familjen, si pjesa më e bukur e jetës, është zëvendësuar me biseda të herëpashershme nëpërmjet telefonave të mençur, ndërsa takimet fizike me të dashurit e zemrës bëhen përmes kamerave dhe përqafimet janë zëvendësuar me “sticker” e gjithë kjo për shkak të “dashurisë” ndaj rrjeteve sociale.
- Nëse telefonin e përdorim për një kohë të gjatë ai do të ketë ndikim negativ të drejtpërdrejtë në sytë tanë; po ashtu qëndrimi në mënyrë jo të duhur bën që ta kemi të kërrusur boshtin kurrizor e si pasojë e kësaj syzet janë shoqërueset më të shpeshta të rinjtë, kurse ecja në mënyrë të kërrusur është bërë e zakonshme.

3.2. Pyetjet

- A kanë ndikuar rrjetet sociale në pasivizimin e të rinjve?
- Shpenzimi i kohës në përdorimi e rrjeteve sociale a e ka zvogëluar kohën e leximit të librave?
- Personi i cili tejkalon përdorimin e nevojshëm të rrjeteve sociale a bëhet më i mbyllur, jo shumë i përkushtuar ndaj familjes dhe më pak i shoqërueshëm?
- A mund të shfaqen edhe deformime në aspektin fizik te personi i cili përdor rrjetet sociale në mënyrë të pakontrolluar?
- Çka mendoni, fëmijët si gjeneratë e re gjithashtu a janë duke pësuar nga ky ndikim?

3.3. Metodologjia e përdorur për hulumtimin tonë

Gjatë hulumtimit tonë kemi përdorur metodën empirike, e ndër to metodën kualitative dhe kuantitative. Për këtë arsye kemi përdorur:

1. Intervista,
2. Anketa,
3. Marrjen në konsideratë të hulumtimeve të tjera të ngjashme me hulumtimin tonë.

Po ashtu kemi përdorur edhe metodën teorike, sepse kemi përdorur edhe libra që direkt ose indirekt lidhen me temën e hulumtimit tonë.

- Intervistat kryesisht ua kemi drejtuar mjekëve, psikologëve dhe sociologëve përkatës prej të cilëve kemi marrë informacione rreth ndikimit të rrjeteve sociale në aspektin shëndetësor.
- Anketat i kemi zhvilluar në kuadër të shkollave fillore, të mesme dhe në universitete, duke përfshirë qytetet kryesore të Kosovës.
- Hulumtimet e tjera të ngjashme me temën e hulumtimit tonë na kanë ndihmuar për ta pasur një pasqyrë rreth asaj se si ka qenë gjendja në një kohë më të hershme, duke i krahasur me këto që i kemi arritur sot.

4. NDIKIMI I RRJETEVE SOCIALE TE TË RINJTË

Interneti, një mjet tejet i përhapur te shoqëria jonë, një trupth fijesh që e ndryshoi shoqërinë njerëzore.

Interneti bart një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe të shërbimeve me anë të të cilave njeriu shërbehet dhe informohet mbi ngjarjet që ndodhin në botë.

Ishte Interneti ai që mundësoi që bota të dukej një “kasolle e vogël” përmes ekranit të së cilës njerëzit informoheshin rreth çdo detaji. Dritare e hapur ishte ky interneti që imagjinatën e njerëzve e thuri në realitet.

Ndikimi i tij është mjaft mbizotërues te njerëzit e veçanërisht tek të rinjtë, megjithatë që të vlerësojmë veprimta-

rinë e tij vlen të cekim përparësitë dhe mangësitë që i kemi nga përdorimi i tij.

4.1 Përparësitë e përdorimit të internetit

4.1.1 Qasja më e lehtë dhe më e shpejtë tek informimi

Interneti na mundësoi hapjen e një horizonti të ri, nga i cili përfitojmë njohuri të ndryshme, qofshin ato njohuri specifike, qofshin të përgjithshme.

Interneti na jep mundësi të informohemi për të rejat e fundit rreth aktualitetit, ekonomisë, botës, sportit, politikës, teknologjisë dhe kulturës.

Dikur njerëzit udhëtonin me ditë të tëra që t'i informonin të tjerët rreth aktualitetit në një vend tjetër, kurse sot me një “klik”, përmes një dritareje programuese, e shohim gjithë botën dhe të rejat rreth saj.

4.1.2 Interneti bashkoi njerëzit që ishin mijëra kilometra larg

Largësia me kilometra ndërmjet familjarëve dikur ishte një “lumë fundosës” që me të madhe filloi të shtrihet tek të gjithë njerëzit e më së shumti te prindërit e gjorë që prisnin te dera me javë e muaj një lajm nga postieri, prisnin mos vallë ka arritur letra e shumëkërkuar. Rrugëtimi i saj i gjatë shpesh shkonte ndesh me jetëshkurtësinë e prindërve,

të cilët vdisnin me mall për mërgimtarët, bijtë e bijat e tyre. Mirëpo, sot “dritarja elektronike” bashkoi zemrat prindër-fëmijë, krijoi kontrata pune, shoi mallin ndërmjet familjarëve dhe mundësoi që buzëqeshja dhe emocionet të përshkoheshin përmes kësaj dritareje. Kështu, “Korniza rrjetëzuese bashkoi njerëzit në skajet e botës”.

4.2 Mangësitë që marrim nga përfitimi i tij

4.2.1 “Ftohja” e lidhjeve farefisnore

Interneti është bërë aq i pashmangshëm nga jeta e njerëzve, sa që ka filluar të prodhojë “një ftohje” në lidhjet farefisnore.

Vizitat ndërmjet të afërmve tanimë janë zëvendësuar me mesazhe elektronike, festat e ngushëllimet me një postim dedikuar atyre, përqafimet prindër-fëmijë janë zëvendësuar me figura programesh të internetit, madje edhe emocionet e gëzimit dhe të pikëllimit më nuk shprehen me fjalë, por me shenja të gjuhëve të programuara.

4.2.2. Shëndeti mendor

The Lancet Child & Adolescent Health bëri intervista me gati 10 mijë adoleshentë në Angli. Studiuesit zbuluan se mediat sociale mund të dëmtojnë shëndetin mendor të vajzave, duke e rritur ekspozimin e tyre ndaj ngacmimeve,

duke e ulur numrin e orëve të gjumit dhe të ushtrimeve fizike.”

4.2.3. Përqendrimi

Me qëndrimin e tyre përballë internetit, duke shfrytëzuar të rinjtë programet e ndryshme që ai ofron, bën që ata ta çrregullojnë orarin e gjumit dhe më pas përqendrimi i tyre ditën vijuese në shkollë nuk do të jetë sikur i atij që do të pushonte me orar, gjumi i tij do të çrregullohej, kurse me çrregullimin e gjumit fillon të rritet stresi, mendja nuk rezonon kthjellët, të rinjtë nuk mund të marrin vendime larg-pamëse.

4.2.4. Varësia nga interneti i bën dëm trurit njësoj si droga dhe alkooli

Kjo varësi, e cila deri tani është definuar si çrregullim në kontrollimin e impulseve, dëmton materien e bardhë të trurit dhe nxit reaksione të varësisë, në mënyrë të ngjashme si te narkomanët.

Këtë dukuri e ka bërë të ditur studimi i Akademisë Kineze të Shkencave nga Wuhan, i kryer në 17 persona të varur nga interneti dhe në 16 që nuk kishin varshmëri. Shkencëtarët kanë përdorur pajisjen për rezonancë magnetike për të incizuar ndikimin e internetit në strukturën e trurit.

Adoleshentët, të cilët ishin të varur nga interneti kishin dëmtime në materien e bardhë të trurit që lidh pjesët vitale

përgjegjëse për emocione, vendimmarrje dhe vetëkontroll. Varësia e tillë për një lloj të caktuar të sjelljes mund të shkaktojë dëmtime të njëjta fizike si edhe varësia nga droga.

Si përfundim, duhet ta kemi parasysh që interneti është një “market” ku shprehja “nuk ekziston” nuk gjendet, por duhet të dimë ta menaxhojmë kohën për marrjen e atyre njohurive, ngase koha është si era, po nuk e menaxhove si duhet ajo ikën e nuk e kupton se si shpërbëhet nga shpejtësia reflektuese e saj.

5. DISA NGA ASPEKTET KONKRETE SE SI NDIKOJNË RRJETET SOCIALE TE TË RINJTË

5.1. Mosleximi

Te të gjithë njerëzit në përgjithësi leximi është një prej faktorëve që mbetet përherë i lidhur ngushtë me zhvillimin mendor, e veçanërisht është i rëndësishëm për jetën e të rinjve, të cilët janë në progres e sipër në jetën e tyre intelektuale dhe jo vetëm atë. Leximi ndonjëherë është edhe mënyrë e përshtatshme për t’u argëtuar, andaj koha e leximit duhet të jetë e veçantë si pjesë e ndarë e ditës. Për ta pasur një marrëdhënie të mirë me librin është e nevojshme që të krijohet një orar, të cilit duhet t’i përmbahesh pavarësisht obligimeve gjatë ditës, duhet të përmbushësh orarin e

leximit me atë që e ke paraparë për ta lexuar, andaj çdo gjë që të shpie në humbje të kohës në mënyrë të kotë dhe pa dobi, është e dëmshme dhe duhet t'i largohemi.

Duhet të zbulojmë shkaqet që na bëjnë ta dëmtojmë kohën tonë të leximit, e nëse e rishikojmë gjithë ditën se me çka merremi mund ta saktësojmë edhe shkaktarin kryesor të humbjes së kohës. Sot, në kohën kur bota po shkon kah zhvillimi, ku gjithçka ka të bëjë me teknikën e me teknologjinë, ne jemi bërë shumë të varur nga një e mirë e madhe që përfshin miliona viruse të vogla që kanë arritur të shumohen brenda trupit tonë dhe fatkeqësisht e kanë kaluar dobinë dhe e kanë infektuar çdo pjesë të jetës; është fjala për internetin në përgjithësi e rrjetet sociale në veçanti, të cilat janë bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë tonë. Realisht ne aty lexojmë, por jo gjithçka që ofrohet është e saktë dhe e nevojshme për ta ditur.

5.2. A mund ta quajmë lexim, leximin e statuseve nëpër rrjete sociale?

Statuset nëpër rrjete sociale ofrojnë një mori informacionesh, madje duke u bazuar në atë se kemi shumë portale, të cilat janë në kuadër të rrjeteve sociale ne mund të marrim shumë informacione dhe të lexojmë në mënyrë të paqëllimshme gjëra që ndonjëherë nuk kanë të bëjnë aspak me profesionin tonë, ose që nuk na duhen në jetën tonë. Bazuar në këtë, i bie se kohën të cilën mund ta kalonim një lexim produktiv për jetë dhe për atë që ne punojmë,

ose studiojmë, e mbushim me informacione të cilat nuk janë në interesin tonë, madje janë informacione që cilat kalojnë në pjesën e harresës që nga momenti kur e shohim se nuk na nevojiten.

Madje, leximi në rrjete sociale ka ndikuar që të kemi një zhvillim të dobët të drejtshkrimit dhe të gramatikës, duke pasur parasysh se shkrimet nëpër rrjete sociale nuk kalojnë në ndonjë proces të kontrollimit nga ana gjuhësore. ”Përdorimi i rrjeteve sociale në mesin e studentëve ka arritur nivele të larta dhe ka ndikuar në kohën e tyre të studimit, gramatikën e dobët dhe shqiptimet e gabuara të fjalëve gjatë kohës në të cilën socializohen në rrjetet sociale ata largojnë edhe vëmendjen prej studimeve të tyre, madje studentët kalojnë pjesë më të madhe të kohës së studimit të tyre nëpër rrjetet sociale sesa në organizimet e tyre akademike e si pasojë e kësaj është edhe mesatarja e ulët e notave.”

5.3. Ngecja në mësim/studime

Studimet janë pjesë e rëndësishme e jetës së çdo të riu. Madje, mund të themi se është pjesa më e rëndësishme e jetës së çdo të riu, ngase dihet që prej kësaj pjese varet edhe e ardhmja e tij intelektuale e materiale, madje edhe e ardhmja e familjes dhe e fëmijëve të tij. Për të pasur studime të suksesshme duhet të kemi edhe kohë, të cilën duhet menaxhuar ashtu që gjithçka të ketë vendin e vet. Orari i rregullt i studimeve duhet të zbatohet nga secili njeri dhe

jo vetëm gjatë studimeve, por edhe gjatë gjithë jetës. Një prej indikatorëve kryesorë për humbjen e orarit të rregullt të mësimit dhe zëvendësimin e atij orari me gjëra të tjera, shpeshherë të panevojshme, janë edhe rrjetet sociale. *“Edukatorët e universiteteve thonë se rrjetet sociale kanë një ndikim pozitiv në bashkëveprimin angazhimin, ndërtimin e njohurive mirëpo sidoqoftë ka edhe hulumtime të tjera të cilat tregojnë se këto mjete mund t’i largojnë nxënësit nga studimet e tyre dhe që i nxisin zvarritjen në të menduarit e tyre në mënyrë sipërfaqësore. Studimet në përgjithësi kanë dhënë të dhëna se rrjetet sociale përdoren nga studentët për t’u socializuar më shumë sesa që përdoren për mësim akademike.”*

Në lidhje me ndikimin e rrjeteve sociale në studime të rinjtë kemi biseduar me sociologun **Redi Shehu**, i cili na tha: *“Një ndër problemet e mëdha, që ka shkaktuar jeta dixhitale e përdoruesve të network-ut, është rënia e dëshirës për lexim. Këto rrjete ulin ndjeshëm nivelin e motivimit sidomos tek studentët. Rrjetet sociale krijojnë varësi duke harxhuar orë të tëra të ditës e natës dhe duke i kthyer në përdoruesit e tyre në qenie joproduktive. Për më tepër ato shkaktojnë dëmtim të kujtesës afatgjatë e cila është thelbësore në lexim. Faktet dhe argumentet shpesh harrohen për shkak të shpërqendrimit masiv që rrjetet sociale shkaktojnë. Bombardimi me imazhe në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme, shkatërron përqendrimin në lexim. Duhet bërë një dallim mes leximit në rrjetet sociale dhe leximit të*

librave. Dallimi qëndron në faktin se i pari është lexim jo i strukturuar dhe i shpërndarë pa synim dhe pa një ide qëndrore, ndërsa i dyti është formues mendimi dhe botëkuptimi dhe kërkon përpjekje dhe përqëndrim më të madh. Të rinjtë sot po vrapojnë pas më të lehtës që është imazheria e rrjeteve sociale dhe argëtimit që kjo të sjellë.”

Libri fatkeqësisht është zëvendësuar me rrjetet sociale dhe rezultatet dëshpëruese të studentëve gjatë studimeve të tyre janë si pasojë e përdorimit të smartphonëve, ndërsa shumë prej të rinjve nuk janë të vetëdijshëm për një gjë të tillë. Ata janë në gjendje që të qëndrojnë orë të tëra me celularin e tyre.

Leximi i lajmeve, artikujve që nuk ofrojnë asnjë dobi për një person janë më të pëlqyeshëm se leximi i një libri, gjë e cila na ka bërë të kemi shumë “banorë digjitalë”. Shprehja “banor digjital” është përdorur nga profesori amerikan Marc Prensky në vitin 2001. Profesori Prensky i ka vështruar studentët e universitetit dhe e ka përdorur këtë nocion për përkufizimin e grupit të të rinjve që janë rritur duke luajtur videolojëra, duke dëgjuar muzikë në mp3 player, duke i përdorur kamerat digjitale dhe celularët. Pra, ne kemi shumë banorë digjitalë dhe shumë pak studiues realë, gjë që na ka drejtuar në një të ardhme, ku të rinjtë janë të varur prej butonave dhe nuk janë aspak kureshtarë për të qenë vetë protagonistë në veprimtari të ndryshme interesante për jetën. Përdorimi i rrjeteve sociale jo vetëm që e “ka mbytur” kohën e studimit, por gjithashtu

ka bërë që një i ri t'i pëlqejë gjërat që arrihen shpejt, pa u lodhur dhe pa shpenzuar shumë energji. Prania e GOOGLE e ka bërë që lidhja ndërmjet informacionit dhe studentit të jetë e shpejtë, pasi vetëm me një klikim të thjeshtë mund të arrihet të ajo që dëshirohet nga ana e tij, pra informacionet, që jo rrallëherë janë edhe të gabuara. Kjo, përveç tjerash, ka bërë që studentët të mos ngelin pa përgjigje. Edhe pse të paverifikuara, ata gjithsesi kanë një përgjigje të shpejtë dhe pa u lodhur duke lexuar libra e artikuj në lidhje me studimet e tyre. E gjithë kjo ka ndikuar në pasivizimin e të menduarit, pasi edhe për informacionet më të thjeshta google-imi është më i lehtë sesa të kthyerit pas në të menduarit e një informacioni që e kanë lexuar diku gjetiu.

Kalimi i kohës kot, informacionet e shpejta, të paverifikuara e të gatshme kanë ndikuar që një student të ketë studime jocilësore duke u munduar që të jetë shumë “i socializuar”.

5.4. Ndikimi negativ në aspektin fizik dhe psikik

Ndikimi i rrjeteve sociale nuk është thjesht varshmëria siç e shohim ne. Nuk janë të rralla rastet kur nevojitet ndërhyrja mjekësore për parandalimin e ndonjëherë edhe për shërimin e sëmundjeve të ndryshme që mund të lindin nga përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale.

Shfaqja e problemeve të ndryshme shëndetësore te të rinjtë është vuajtje për vetë personin si dhe ndikimi në aspektin psikik tek e gjithë familja, e cila nga një individ i sëmurë shndërrohet në një familje me pasoja. Gjatë bisedës në lidhje me ndikimin e rrjeteve sociale në aspektin psikik dhe fizik, sociologu **Redi Shehu** ka pohuar:

“Qëndrimi me orë të zgjatura para pajisjeve elektronike, përveç dëmeve psikologjike, shkakton padyshim edhe deformime fizike, për shkak të apatisë reale e cila shtrihet me orë të tëra në deformime të kolonës dhe vertebrave të qafës. Në brezin e ri këto simptoma mund të mos ndjehen tani, por me kalimin e kohës ka shumë mundësi të përballimi me një brez i cili do të vuajë nga dëmtime të theksuara të kolonës dhe vertebrave, si dhe sëmundjeve të artritit të cilat kanë në bazë pasivitetin dhe mungesën e aktivitetit fizik. Aktiviteti i munguar fizik, privon edhe trurin nga sasia e duhur me oksigjen duke ulur kapacitetin përthithes dhe intelektual tek të rinjtë.”

Ndërsa psikologu **Fitim Uka**, në lidhje me këtë temë ka thënë: *“Në mesin e dëmeve të tjera psikologjike, shkakton edhe një imazh të gabuar për veten, që varet nga pëlqimet e miqve në rrjetet sociale. Për më tepër, injoron intelektin dhe i jep përparësi të theksuar, pamjes, veshjes dhe attributeve fizike, në vend se të çmojë e ç'vlerësojë mendjen dhe "shpirtin". Të shumtë janë ata që gjejnë prehjen në rrjetet sociale dhe më pas harrojnë cila është ndjesia e jetës së vërtetë.”*

Ndërkaq, një varg simptomash që korrespondojnë me stresin, depresionin dhe ankthin mund të përcillen nga aktiviteti i tepër në rrjetet sociale. "Ndërkohë e kemi marrë mendimin edhe të logopedes **Adelina Haxhiu**, e cila ka treguar se si duhet menaxhuar mirë koha që shpenzohet në rrjete sociale dhe ajo në aktivitete: *“OBSH sugjeron që prindërit të zëvendësojnë kohën e ekranit me më shumë aktivitete pasuruese. Koha e ulur cilësore e kaluar në aktivitete interaktive jo-ekran të bazuara me një kujdestar, të tilla si leximi, tregimi, këndimi dhe enigmat, është shumë e rëndësishme për zhvillimin e fëmijëve. Së bashku me rekomandimet e saj për ekranin, OBSH gjithashtu publikoi udhëzime për aktivitetin fizik dhe gjumin.”*

Rrjetet sociale kanë arritur që njerëzit të jenë të dhënë pas komplimenteve nëpër komente dhe komunikimit aty e aspak të interesuar për të kontaktuar me njerëzit drejtpërdrejtë. Nga komunikimi përmes internetit është mundësuar që njerëzit edhe ta ofendojnë njëri-tjetrin dhe të mos ndihen të turpëruar, pasi nuk shihen kur e bëjnë një gjë të tillë. Kështu kanë lindur edhe “internet xhuxhët” që janë njerëz të cilët postojnë komente ofenduese në forume, ose në ndonjë blog, me një fjalë kudo që u jepet mundësia. Kuptohet, përdoruesve të internetit nuk mund t’iu pëlqejë gjithçka dhe secili mund ta shprehë mendimin që e ka, por komentet e xhuxhëve janë aq irrituese dhe janë nën nivelin e kritikës. Pra, kështu kanë lindur njerëz me probleme psi-

kologjike, të cilët tentojnë ta përmirësojnë vetëbesimin e tyre duke i ofenduar të tjerët.

Pra, nga kjo e shohim se rrjetet sociale mund të na shkaktojnë probleme më madhore sesa është humbja e kohës, pra probleme shëndetësore, psikike e fizike, që mund të jenë edhe të pashërueshme. Pasojnë edhe deformime, të cilat nuk mund të kthehen në gjendjen normale, shkaktojnë probleme psikologjike që të bëjnë ta duash veten e të ndjehesh superior, gjë që ndikon negativisht edhe në zhvillimin e personalitetit të njeriut.

5.5. Moskalimi i kohës së lirë me familjen e shoqërinë dhe lënia e tyre anash

Familja është bërthama, jeta, mbështetja dhe dashuria më e madhe e secilit person. Pas një dite të bukur apo të mërzitshme, të rehatshme apo të lodhshme, në fund kthehemi te njerëzit të cilët janë mbështetja më e madhe. Mirëpo sot telefoni e ka zbehur madje edhe marrëdhëniet më të ngushta ndërmjet familjarëve e deri te marrëdhëniet me gjithë shoqërinë. Interneti i bashkoi njerëzit me mijëra kilometra larg, në anën tjetër shumë prej njerëzve i shndërroi në robotë që kanë mendje, por mendojnë vetëm pasi ta humbin interesin prej asaj që e shohin në telefon e në të kundërtën as që të japin përgjigje. Varësia nga përdorimi i telefonit është bërë një zakon. Madje shumë persona, edhe duke qëndruar me dikë, shkruajnë përmes telefonit rreth bisedës të cilën do të ishte shumë më e lehtë ta zhvillonin

me zë. Përdorimi i tepërt i internetit e ka bërë një të ri të “robëruar” pas telefonit të tij, pasi nëse nuk e ka telefonin me vete është në gjendje të bëjë gjithçka vetëm e vetëm ta ketë përsëri afër, sepse me të e ndjen “sigurinë” në kalimin e kohës në çdo vend. Jemi bërë adhurues të komunikimit me ndërmjetësim dhe aspak nuk e pëlqejmë komunikimin “face to face”, edhe pse ky i fundit e ruan marrëdhënien e komunikimit dhe të dashurisë. Njëkohësisht të komunikuarit me dikë duke e parë në sy dhe duke ia bërë me dije se je duke e dëgjuar me vëmendje, është shumë më efikas sesa kthimi i përgjigjes përmes telefonit, edhe nëse përgjigjeni shpejt e bukur.

Lidhur me këtë kemi biseduar me sociologun **Redi Shehu**, i cili na tha:

“Pas revolucionit industrial i cili furishëm përcaktoi edhe shndërrimin e shoqërive nga tradicionale në ato moderne, në dekadat e fundit revolucioni dixhital e përshpejtoi ndryshimn e mënyrës se si ne iu qasëm këtij moderniteti. Ndërsa vitet e fundi ne sot po përballemi me një revolucion tjetër që është “revolucioni i touch screen-it”, i cili e personalizoi realitetin dhe boshtin e tij drejt individit. Pra, individi u kthye ne qendër të këtij revolucioni dhe kahja sociale nuk është më nga një shoqëri e drejt individit, por tashmë ne sot me “touch technology” i qasemi realitetit nga individi drejt shoqërisë. Në këtë këndvështrim, individi si përdorues i teknologjisë, merr attribute të rëndësishme sociale. Ai në të njëjtën kohë është kudo, por

në të njëjtën kohë realisht ndodhet i vetmuar në qelinë e tij dixhitale.”

Psikologjikisht, ky është një transformim rrënjësor, sepse qenia njerëzore është e krijuar si qenie sociale, si qenie e ndërveprimit me individë dhe komunitete të tjera. Është pikërisht ky ndërveprim që përcakton shkallën e socializimit të tij. Është përmes këtij ndërveprimi që ai rehatohet në aspektin psikologjik në marrëdhëniet me të tjerët. Komuniteti, grupi, bashkësia dhe jeta brenda tyre është terapia më e mirë sociale e cila ndërton shoqëri të rregulluara në të gjitha aspektet. Me revolucionin e touch-it, pra, me izolimin më të madh të individit brenda lirisë së tij të rreme, marrëdhënia e tij me grupet, komunitet, dhe bashkësitë, transformohet nga formati fizik në atë dixhital duke e shndërruar të gjithë këtë marrëdhënie në një vetmi jo vetëm fizike por në një vetmi psikike, pa ndërveprim karakteresh. Duhet theksuar se shpirti dhe karakteri i njerëzve perceptohet apo shijohet mbi të gjitha përmes kontaktit fizik, përmes mimikës dhe syve të tij.

Dixhitalizimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore e ftoh këtë kontakt, ngase njeriu në network është veçse shëmbëlltura e rreme e vetvetes jo formati real i tij. Shpërndarja masive e smartfonëve në një fare mënyrë ka shkakuar një “demokratizim” të vetëshfaqjes dhe portretit, pavarësisht shtresës sociale së cilës i përket. Më parë portretet ishin atribut i aristokracisë dhe mbretërve, ndërkohë që populli i thjeshtë nuk e gëzonte këtë privilegj. Masivizimi i pajisjeve

elektronike e ka demokratizuar veshfaqjen duke i bërë të gjithë të bëjnë portrete e jo vetëm një kastë e caktuar. Duke përdorur imazhe të kuruara të vetvetes në rrjetet sociale, me qëllim që të ndërtohet një imazh publik, individi i sotëm harron që ky imazh në thelb është një imazh i rremë që çon psikologjikisht drejt një identiteti të fabrikuar. Vaniteti, narcizizmi, ambicja dhe ngutja sociale, kanë qenë tipare të përhershme të njeriut. Teknologjia vetëm sa i ka nxjerrë ato më në pah dhe i ka shumëfishuar përmes lehtësimit të realizimit me anë të teknologjisë si dhe lehtësisë së shpërndarjes sociale tek njerëzit. Imazhet në rrjetet sociale, instagrame etj. Nuk frymëzojnë askënd dhe nuk sjellin ndryshim, i vetmi ndryshim që sjellin është ai i brendshëm që i transformon në maniakë.

Sistemi që bazohet në like apo pëlqime, ngjan me “colosseume dixhitale” ku gishti lart apo poshtë përfaqëson elektronikisht ekzekutimin ose jo modern të tjetrit. Kështu, pa frikë rrjetet sociale në mënyrën se si përdoren sot, po shndërrohen në armën dixhitale të shkatërrimit në masë. Rrjetet sociale kanë vetëm një betejë për ta fituar. Ajo është beteja për vëmendjen psikologjike të ndjekësve të vet. Sepse vëmendja fiton para dhe për këtë duhen sa më shumë gjëra që prodhojnë vëmendje, e ku ka më lehtë se sa vaniteti, lakuriqësia si mekanizma për të prodhuar vëmendje? Psikologjikisht këto rrjete po humbin kuptim që njeriu ka pasur për intimitetin, sot brezi i ri përdorues i

tyre nuk di se çfarë do të thotë intimitet. Lakuriqësia publike ka zhdukur ndjenjën e intimitetit tek njerëzit.

Seksualitetit i tepruar ka vrarë ndjenjën e sensualitetit. Sot rrjetet sociale, Instagram, FB, ngjajnë të gjitha si një panair prej mishi njerëzor, një skllavëri e vetdëshiruar ku njerëzit shesin hiret e tyre për para. E gjitha kjo shkakton pasoja të pariparueshme në ndërgjegjet dhe shpirtrat e përdoruesve dixhitalë. Pasojat pastaj janë të shumanshme. Ato shkarkojnë përgjegjësine e individit ndaj të tjerëve në sajë të mungesës së kontaktit fizik.

Mbështetur në teorinë e Zigmund Bauman i cili thotë se largësia humb ndjeshmërinë e një akti, atëhere psikologjikisht, në vetmi dixhitale, njeriu mund të shndërrohet në një dëmtues dhe përbindësh ngase mungesa e kontaktit fizik ia lehtëson atij keqbërjen. Po ashtu, i izoluar nga shoqëria, njeriu si qenie me attribute morale, fillon të humb kuptimin e tij mbi të mirën dhe të keqen sociale. Mbyllet në vetvete. Kthehet në qenie pasive, pa synime, pa një dëshirë për botën që e rrethon. Kapaciteti i imagjinatës së tij është i reduktuar vetëm brenda botës dixhitale dhe lidhja me natyrën dhe familjen kthehen në vegime të humbura. Rrjetet sociale janë në thelb izoluere dhe prodhuere të vetmisë, depresionit dhe ankthit. Shpesh dëmi më i madh nga rrjetet sociale, e sidomos nga instagrame vjen nga procesi i krahasimit të vazhdueshëm me pritshmëritë jo reale, sepse pamjet e publikuara në këto rrjete janë të kompozura me kujdes, nuk janë reale, dhe duke qenë kështu, prishin kufi-

rin mes të mirës dhe të keqes natyrale. Gra dhe vajza të shumta ndjehen të porealizuara sepse trupi apo hiret e tyre nuk janë si ato të vipave të retushuara të rrjeteve sociale dhe kjo u shkakton ndjenjë të depresionit dhe ankthit duke i mbyllur në vetvete dhe duke ulur vetëbesimin për veten. Njeriu i ri dixhital, është një prototip i cili rrezikon të kthehet në varrmihësin e shoqërisë në të cilën jeton, shpirti fillon të vdesë ngadalë, kujtesa afatgjatë fillon dhe dëmtohet, shpërqendrimi bëhet akoma më i madh për shkak të efektit “tranzit” që mediat sociale gëzojnë. Ky efekt tranzit shkaktohet për shkak të portabilitetit të ekraneve të vogla me anë të lëvizshmërisë së tyre. E gjitha përmbledhet në një “fast-info”, i cili përveçse është i shpejtë, mbi të gjitha është i cekët. Egoja e tij sundon mbi të, për shkak të vetmisë e cila nuk ia lejon që nefsi të edukohet në terapinë e grupit dhe komunitetit, për këtë arsye deformimet psikologjike janë më të prirura të marrin rrugë pikërisht për shkak të vetmisë së tij. Rrjetet sociale nxisin botëvështrimin egocentric mbi shoqërinë ku “vetja” kthehet në plan të parë në kohën kur ne sot kemi më shumë se kurrë nevojë për altruizëm. Nuk mund ta përmirësojmë këtë shoqëri nëse nisemi nga premise e vetes në plan të parë.

Narcizizmi i nxitur në rrjetet sociale i bën njerëzit të kthehen në ekstremistë të vetvlerësimit duke shkuar drejt një egoje destruktive. Mediat sociale e bëjnë të vështirë dallimin mes lidhjeve reale në botën tonë me lidhjet rastë-

sore të ndërtuara në mediat sociale. Kjo çon drejt një ndjeje fallso të komunikimit. Duke shtuar komunikimin me të panjohurit në pakësojmë komunikimin real me të njohurit, shtoi ndër të tjera sociologu Shehu.

Pra, nga ajo që biseduam me sociologun Shehu, e vërtetuam atë që njeriu, me anë të rrjeteve sociale, e humb edhe kontrollin kujtesës së tij, bëhet i vetmuar, mësohet me lajme të gatshme e me shoqëri rastësore. Kjo e fundit e bën njeriun që të ngatërrojë atë që është reale dhe atë që është false, e ngatërrimi i kësaj e bën njeriun që të përqendrohet në gjëra që e dëmtojnë personalitetin e tij dhe të rrethit në të cilin jeton.

Gjithashtu gjatë bisedës sonë, psikologu **Fitim Uka** ka thënë: *“Është tashmë një fakt i konfirmuar nga shumë burime, që përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale ndikon negativisht në shumë procese të rëndësishme psiko-sociale. Mbi të gjitha, përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale, shkakton varshmëri nga teknologjia edhe kësaj krijon një çrregullim, që është sfidues për t'u trajtuar. Në anën tjetër, është i mirënjohur fakti që përdorimi i rrjeteve sociale, anipse rrit numrin e miqve virtualë, zvogëlon numrin e miqve realë.”*

Fjalët e psikologut Fitim Uka janë në përputhje me mendimin tonë se përdorimi i rrjeteve sociale e bën një njeri të varur, kurse varshmëria ndaj diçkaje detyrimisht bën që njeriu të largohet nga gjërat që dikur i ka pasur të rëndësishme. Për shembull, kalimi i kohës me familjen është zë-

vendësuar me kalimin e kohës me miqtë virtualë, ndërsa një shoqëri e tillë jo rrallëherë është e dështuar. Në këtë rast njeriu, i cili përdor rrjetet sociale në mënyrë të pakontrolluar humb veten, kohën, familjarët dhe miqtë e tij të vjetër për një shoqëri të re, e cila është e ndërtuar mbi një bazë të paqëndrueshme.

Pra, rrjetet sociale kanë ftohur marrëdhëniet ndërmjet familjes e shoqërisë e për rrjedhojë ka lidhur në një dashuri supreme telefonin dhe njeriun, ku njeriu e do aq shumë telefonin, sa i dhimbset më shumë nëse i thehet ekrani i telefonit sesa nëse bëhet shkëputja apo “thyerja” e marrëdhënieve me personat e tij më të dashur të jetës.

6. REZULTATET DHE DISKUTIMET

Çdo person, i cili është përdorues i rrjeteve sociale, e ka një arsye që e shpie atë që t’i përdorë. Disa prej njerëzve i kanë të qarta arsyet për të cilat i përdorin rrjetet sociale, por disa të tjerë, edhe pse në shikim të parë thonë se nuk kanë ndonjë arsye, edhe tek ata gjendet një arsye abstrakte që i bën të jenë përdorues të tyre.

6.1. Arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale

1. Cila është arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale:

Shteti **Gjina**
Kosovë **Djem** **Vajza**

Niveli
 Moshë
Shkolla fillore - Shkolla e mesme - Bachelor

13 - 29 vjeç



14% a - Për studime
 7% b - Për anglim
 27% c - Për t'u informuar
 17% d - Për të kaluar kohën e lire

- 7% (a : b)
- 6% (a : c)
- 6% (a : d)
- 1% (a : b : c)
- 0.1% (a : b : d)
- 4% (c : d)
- 1% (a : b : c : d)
- 3% (a : c : d)
- 2% (b : c)
- 1% (b : d)
- 4% (b : c : d)

1357 të anketuar

Nga rezultatet tona kemi parë se në Komunën e Prishtinës të rinjtë, të cilët janë nën moshën 20-vjeçare, janë të rrezikuar jashtëzakonisht shumë nga përdorimi i rrjeteve sociale, pasi ata me përqindje shumë të lartë janë përgjigjur se në rrjete sociale e kalojnë kohën e lirë. Realisht fëmijët në atë moshë janë në formim të personalitetit dhe kalimi i kohës së lirë në rrjete sociale do të ndikojë negativisht tek ata. Në anën tjetër të rinjtë mbi moshën 20-vjeçare, gjegjësisht ata të cilët janë duke ndjekur studimet universitare, në përgjigjet më të shpeshta pohonin se rrjetet sociale i përdorin për t'u informuar, gjë e cila është më e kënaqshme në krahasim me përgjigjen e grupit të parë, ndonëse ka vend për të menduar se me çfarë informimi ka të bëjë kjo, por gjithsesi është një përgjigje që në vete ngërthen shumë e shumë të mira. Në anën tjetër, të rinjtë të cilët janë duke studiuar, një numër i konsiderueshëm i tyre, janë deklaruar se rrjetet sociale i përdorin për studime e që i bie se ata mbase lexojnë edhe libra nëpërmjet rrjeteve sociale, kurse të rinjtë të cilët janë nën moshën 20-vjeçare, në një përqindje më të vogël, kanë deklaruar se rrjetet sociale i përdorin për nevoja të studimeve. Ajo që është shqetësuese te të rinjtë e Prishtinës është se ata në përqindje minimale e kanë pranuar se rrjetet sociale i përdorin për argëtim dhe kjo është në kundërshtim me pritshmëritë tonë, pasi, përkundër gjithë negativitetit të kalimit të kohës në mënyrë të kotë, të paktën kemi pretenduar se ata të rinj, që kalojnë kohën në rrjete sociale, të argëtohen qoftë edhe në mënyrë të përkohshme gjatë përdorimit të tyre.

Në anën tjetër, në qytetin e Prizrenit, fëmijët të cilët nuk janë në studime ende kanë dhënë përgjigje me përqindje të lartë, duke pohuar se rrjetet sociale i përdorin për t'u informuar më shumë se gjithçka tjetër, ndërkohë ata që janë në studime kanë dhënë përgjigje se rrjetet sociale i përdorin për studime shumë më shumë sesa për arzetim e për kohë të lirë. Këto përqindje janë disi më të kënaqshme në Komunën e Prizrenit në krahasim me Komunën e Prishtinës.

Në Gjilan, shumica e të rinjve rrjetet sociale i përdorin për informim dhe për kalimin e kohës së lirë, ndërsa një përqindje shumë e vogël kanë dhënë përgjigje se rrjetet sociale i përdorin për studim.

Mitrovica gjithashtu ishte në gjendje sikurse Gjilani, ku të rinjtë më shumë i përdorin rrjetet sociale për kalimin e kohës së lirë, kundruall përdorimit për studime dhe informim.


Podujeva ishte njëra prej komunave ku ishin pak më të ekuilibruara raportet ndërmjet argëtimit dhe shfrytëzimit brenda kornizave normale të rrjeteve sociale, pasi përqindja për informim ishte më e mirë sesa ajo për argëtim dhe kalim të kohës së lirë.

Gjakova kishte një përqindje të barabartë rreth argëtimit dhe kalimit të kohës së lirë, ndërkohë që ata me shumicë ishin deklaruar se rrjetet sociale i përdorin për të studiuar më shumë sesa për gjithçka tjetër.

Ndërkohë Ferizaj, në anën tjetër, ishte ndërmjet dy skajeve. Ata në anketimet e tyre janë përgjigjur me shumicë se rrjetet sociale i përdorin për studime dhe në një përqindje të vogël janë përgjigjur se i përdorin për argëtim.

6.2. Koha e kaluar në rrjetet sociale si kohë e humbur

2. A mendoni që koha që ju kaloni në rrjetet sociale, ju humb kohën me familjen tuaj?



Koha është pjesa më e rëndësishme e jetës së një njeriu. Nëse një pjesë të kohës së tij e kalon diku, nuk mund ta kalojë edhe diku tjetër njëkohësisht. Kjo është veçantia e asaj që e themi “humbje kohe”, pasi nëse je duke e kaluar kohën me rrjete sociale, ti nuk mund të jesh duke “kaluar kohën” diku tjetër, me të dashurit e tu. Pikërisht kjo na intereson në se të rinjtë janë duke ditur ta menaxhojnë kohën e tyre.

Rreth kësaj çështjeje në Komunën e Prishtinës përgjigjet më të shpeshta prej të rinjve janë se ndonjëherë rrjetet sociale ua humbin kohën që do të duhej ta kalonin me familjen, ndërsa menjëherë pas kësaj përgjigje pason përgjigjja, që realisht edhe nuk do të donim të ishte e tillë, e ajo është se ata janë përgjigjur se PO rrjetet sociale ua harxhojnë kohën e tyre të vlefshme të rezervuar për familjarët, të cilën fatkeqësisht e zëvendësojnë me përdorim të telefonave të mençur.

Në Komunën e Prizrenit gjithashtu qëndronte situatë pothuajse e njëjtë me Komunën e Prishtinës. Përgjigjet, si prej të rinjve të cilët janë mbi moshën 20-vjeçare, ashtu edhe prej atyre që janë nën moshën 20-vjeçare, janë të të njëjtit nivel d.m.th. shumica prej tyre thonë se ndonjëherë koha e tyre e rezervuar për familjarët po mbushet me kohë të internetit dhe shumë prej tyre janë përgjigjur se PO një gjë e tillë po ndodh pa pikë mëdyshjeje.

Në Gjilan, krahas renditjes së njëjtë të përgjigjeve, sikur Prishtina e Prizreni, kishte edhe prej atyre të cilët u

përgjigjën se koha e përdorimit të rrjeteve sociale nuk mund të ndikojë në kohën e paraparë për ta kaluar me familjarët.


Mitrovica ishte e përafërt me Prishtinën dhe Prizrenin, me të njëjtat rezultate, që fatkeqësisht ishin të pakënaqshme rreth kësaj çështjeje.

Situata e Podujevës ishte e ngjashme me atë të Gjilanit, edhe pse kishte shumë prej atyre që ishin përgjigjur me “po” dhe “ndonjëherë” gjithsesi kishte edhe pak prej rezultateve, të cilat i donim dhe i prisnim që të përgjigjeshin se “JO rrjetet sociale nuk mund të na e marrin kohën e artë të familjes”, edhe pse në përqindje shumë të vogël ishin këto rezultate gjithsesi ekzistonin.

Në Gjakovë, situata ndryshonte, ngase aty të rinjtë, të cilët janë duke përfunduar studimet, janë përgjigjur se ata ndonjëherë e humbin kohën në rrjete sociale, duke e privuar familjen, por jo gjithmonë, pasi në përqindje të madhe ata janë deklaruar se kohën e familjes e kanë shumë me vlerë dhe nuk mund ta mbushin me diçka tjetër.

Në Ferizaj, në përqindjen maksimale kanë thënë se rrjetet sociale nuk ndikojnë në humbjen e kohës në to dhe moskalimin e kohës me familjarët.

6.3. Qëndrimi i pakontrolluar në rrjete sociale



Qëndrimi i pakontrolluar në rrjete sociale bën që një i ri të kalojë kohë më të gjatë pranë kompjuterit, telefonit apo mjeteve të tjera teknologjike, duke i shkaktuar atij ndikim negativ në shumë aspekte të jetës.

Rreth asaj se sa kohë kalojnë në rrjete sociale, të rinjtë e Prishtinës e shkollës fillore, apo të mesme, e kanë orarin e tyre më të kontrolluar. Ndoshta për shkak të moshës, ende prindërit, apo kujdestarët e tyre, përkujdesen për këtë gjë, andaj edhe rezultati është mesatar, pasi që ata në rrjete sociale janë deklaruar se qëndrojnë 1-2 orë, ndërsa të rinjtë, të cilët janë në studime universitare variojnë prej 2-3 orë qëndrim në rrjete sociale. Dihet se të rinjtë në universitet nuk është se kanë edhe kontroll shumë të madh nga dikush, pasi ata në jetën e tyre pavarësohen.

Edhe në Prizren shihet se te të rinjtë, të cilët janë nën moshën 20-vjeçare, ka një kontroll ose një sistem të brendshëm familjar për rregullimin e kohës për qëndrim në rrjete sociale, pasi edhe aty përgjigjet janë në mes 1-2 orë e më rrallë 2-3 orë, ndërkohë që të rinjtë të cilët janë në studimet universitare janë deklaruar se qëndrojnë në rrjete sociale 2-3 orë, por shumë herë edhe më shumë se 4 orë, gjë e cila është mjaft shqetësuese.

Në Gjilan, pjesëmarrësit janë të larmishëm në përgjigje, pasi te të gjitha kategoritë e të rinjve ka prej tyre që qëndrojnë më pak se 1 orë e që në numër janë të paktë, pastaj me shumicë ka që qëndrojnë 1-2 orë pranë rrjeteve sociale, ndërsa ata që kalojnë 2-3 orë dhe më shumë se 4 orë janë më pak, por gjithsesi ka edhe prej tyre.

Mitrovica është me rezultate jo të kënaqshme, pasi të rinjtë e Mitrovicës janë deklaruar se qëndrojnë në rrjetet sociale më shumë se 4 orë me shumicë, ndërsa menjëherë

pas kësaj janë deklaruar edhe të tjerët që qëndrojnë 1-2 orë e që janë dukshëm më të paktë në numër sesa ata që janë në ekstremin e 4 orëve e më tepër.

Podujeva pason me 1-2 orë në një përqindje të madhe, te të gjitha grupmoshat, ndërsa përqindje e përafërt me këtë të parën është 4 orë e më tepër te të rinjtë të cilët janë mbi moshën 20-vjeçare.

Gjakova, edhe përkundër statistikave të mëhershme që qëndronte më mirë, kësaj radhe del se një përqindje e madhe e të rinjve të saj i kalon 2-3 orë në rrjetet sociale. Afër këtij numri të madh janë edhe ata që qëndrojnë në rrjetet sociale 4 orë e më tepër, rezultat ky jo i kënaqshëm.

Ferizaj edhe kësaj radhe qëndron në dy skajet më të padëshiruara e që janë 4 orë e më tepër dhe 2-3 orë kalim kohe në rrjetet sociale. Kjo bën që të rinjtë e Ferizajit të mos jenë menaxhues të kohës së tyre.

6.4. Varësia nga rrjetet sociale

4. Sa jeni të varur nga rrjetet sociale, dhe a keni provuar t'iu largoheni për një kohë?

Shteti Gjinia

Kosovë Djem Vajza

Niveli

Shkolla fillore - Shkolla e mesme - Bachelor

Moshë

13 - 29 vjeç



1374 të anketuar

Kur në diçka që fiksohesh, nuk janë të rralla rastet kur ato krijojnë varshmëri tek ti. Dëshira e madhe për të qëndruar në rrjetet sociale është shndërruar në varshmëri te të rinjtë, të cilët ka raste kur e dinë që janë të varur dhe duan të largohen, por këtë e shohin si diçka të pamundshme. Megjithatë, ka edhe raste të tjera kur ata nuk e vërejnë aspak se janë të varur, madje edhe nëse dëshiron t'i njoftosh mund të përgjigjen me arrogancë.

Në këtë çështje të rinjtë e Prishtinës pretendojnë që nuk ndihen të varur nga rrjetet sociale dhe vetëm ndonjëherë rrallë e ndiejnë këtë varshmëri, por ka edhe prej tyre, në një përqindje të përafërt me këtë të parën, që thonë se janë të varur dhe kanë menduar që t'iu largohen rrjeteve sociale. Megjithëse ekzistojnë përgjigjet e të gjitha kategorive, duke përfshirë edhe ata që vetëm i përmendëm më lart, pra ata që kanë varshmëri, por, megjithëkëtë, as që mendojnë t'iu largohen ndonjëherë kësaj varshmërie.

Respondentët nga Prizreni, në anën tjetër, nuk ndihen të varur, ose ndihen të varur vetëm ndonjëherë, gjë që janë përgjigje më të kënaqshme në krahasim me Prishtinën, edhe pse në mesin e te rinjve prizrenas ka edhe prej atyre që nuk mendojnë të largohen prej rrjeteve sociale, ndonëse kanë varshmëri. Disa prej tyre që mendojnë se janë të varur dhe duan të largohen prej rrjeteve sociale, e që janë shumë më të dobishëm se kategoria e parë, të cilët nuk mendojnë të ndër marrin masa përmirësuese për jetën e tyre.

Në Gjilan të rinjtë mendojnë se janë të varur dhe duan të largohen prej rrjeteve sociale shumë më shumë sesa të rinjtë të cilët mendojnë se janë të varur dhe se nuk duan të largohen prej rrjeteve sociale. Mirëpo, ka edhe prej atyre

(e që janë në përqindje bukur të madhe) që mendojnë se nuk janë të varur prej rrjeteve sociale.

Të rinjtë e Mitrovicës mendojnë se kanë varshmëri dhe se duhet të largohen prej rrjeteve sociale e po ashtu në përqindje të përafërt me këtë të fundit është se ata, jo gjithmonë, mendojnë se janë të varur prej rrjeteve sociale, por kjo mund të ndodhë vetëm ndonjëherë me raste.

Podujeva kësaj radhe gjendet mes dy skajeve, pasi me shumicë të rinjtë e saj janë përgjigjur se ndihen të varur prej rrjeteve sociale dhe se duhen të largohen e, në anën tjetër, në një përqindje pak më të vogël se kjo të rinjtë mendojnë se janë të varur prej rrjeteve sociale, por nuk duan të largohen prej tyre.


Kemi marrë përgjigje interesante prej të rinjve të Gjakovës, të cilët në përqindje të madhe janë deklaruar se nuk kanë varshmëri prej rrjeteve sociale. Menjëherë pas kësaj disa të rinj kanë thënë se ata ndiejnë varshmëri, por nuk duan të largohen prej rrjeteve sociale e që këta të fundit ishin shumë afër në numër me ata të kategorisë të parë, të cilët janë më të preferuarit e këtij anketimi.

Në Ferizaj, edhe kësaj radhe, respondentët janë paraqitur me mendim krejtësisht ndryshe. Sikurse radhëve të tjera, të rinjtë e Ferizajt me shumicë të madhe janë deklaruar se, edhe pse ndihen të varur nga rrjetet sociale, nuk duan të largohen prej tyre. Kjo përqindje është larg pritshmërive tona, ndërsa menjëherë pas kësaj përgjigjeje, ata janë deklaruar (edhe pse në numër shumë më të vogël sesa grupi i parë) se janë të varur dhe se duan të largohen prej rrjeteve sociale.

6.5. Mosleximi si pasojë e rrjeteve sociale

5. Sa ndikon përdorimi i rrjeteve sociale në jetën e studentëve dhe a ju pengon për mos-lexim?

Shkri Kosovë
Gjinia Djem Vajza
Niveli Shkolla fillore - Shkolla e mesme - Bachelor
Mosha 13 - 29 vjeç



Studimi është pjesa e jetës së një të riu. Për të nxënë ditudi ai duhet të jetë i përkushtuar dhe të kalojë një kohë bukur të madhe i koncentruar në studim. Telefoni dhe rrjetet sociale janë prej gjërave të cilat më së shumti ndikojnë në shpërqëndrim te pothuajse çdo student.

Të rinjtë e Prishtinës, numri më i madh i tyre, janë shprehur se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë në studimet e tyre, kurse pas kësaj pasonte përgjigjja se ata mesatarisht janë të ndikuar nga rrjetet sociale në studimet e tyre. Të dyja këto përgjigje janë negative sa i përket dobisë për studentët.

Gjendja pothuajse ishte e njëjtë edhe me të rinjtë e Prizrenit, të cilët kanë deklaruar se ndonjëherë janë të ndikuar nga rrjetet sociale, ndërsa shumica e tyre kanë thënë se mesatarisht ndikohen prej rrjeteve sociale në studimet e tyre.

Gjithashtu edhe të rinjtë e Gjilanit sillen rreth përgjigjeve që pohojnë se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë dhe mesatarisht në jetën e tyre studentore.

Përgjigje të kënaqshme, kanë dhënë të rinjtë e Mitrovicës, pasi ata me shumicë janë përgjigjur se rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak në studimet e tyre, ndërsa një numër pak më i vogël sesa të parët kanë thënë se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë në studimet e tyre.

Podujeva sillen rreth opcioneve të përgjigjeve “aspak” dhe “ndonjëherë”. Numri më i madh i të rinjve janë përgjigjur se ndonjëherë rrjetet sociale ndikojnë në studime,

ndërsa një numër po ashtu i konsiderueshëm i tyre janë përgjigjur se rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak në studimet e tyre.

Gjakova vjen me përgjigjet “ndonjëherë” dhe “mesatarisht”. Numri më i madh i të rinjve të Gjakovës janë përgjigjur me “ndonjëherë”, ndërsa të tjerët janë përgjigjur me “mesatarisht”. Por ka pasur edhe prej atyre që janë përgjigjur se rrjetet sociale ndikojnë shumë në studimet e tyre. Këtë përgjigje nuk do të donim ta kishim në asnjërin qytet të vendit tonë.

Ferizaj është përgjigjur njëjtë sikurse Gjakova. Do të thotë se shumica e të rinjve të Ferizajt kanë thënë se ndonjëherë në jetën e tyre ndikojnë rrjetet sociale, ndërsa në një përqindje më të vogël se e para kanë thënë se rrjetet sociale ndikojnë mesatarisht në jetën e tyre studentore.

6.6. Rrjetet më të përdorura


6. Cilin rrjet social e përdorri më së shumti:

Shkollë Kosovë **Gjenera** **Djem** **Vajza**

Niveli Shkollia fillore - Shkollia e mesme - Bachelor

Mosha

13 - 29 vjeç



18% a - Facebook
38% b - Instagram
2% c - Twitter
11% d - Youtube
3% e - Snapchat

8% (a:b) 1% (a:c) 2% (a:d) 0.1% (a:b:c) 2% (a:b:d) 0.1% (a:b:c:d) 4% (b:c) 5% (b:d) 1% (a:b:c:d)

1% (c:d) 0.1% (a:c:e) 1% (b:d:e) 0.1% (c:e) 1% (a:b:c:d:e) 0.1% (a:b:e) 12% (b:e) 0.3% (b:c:e)

1388 të anketuar

Rrjetet sociale janë të shumta dhe varësisht prej asaj se për çka shërbejnë e tillë është edhe përdorueshmëria e tyre.

Të rinjtë e Prishtinës e përdorin më së shumti instagramin, të pasuar nga facebooku, youtube e twitteri. Pra, instagrami është prej rrjeteve sociale më të pëlqyeshme nga ana e të rinjve në Komunën e Prishtinës.

Gjithashtu edhe të rinjtë e Prizrenit më së shumti pëlqejnë instagramin dhe pastaj në renditje, diku më pak e diku më shumë, vijnë youtube si dhe facebooku. Të titteri mbetet shumë prapa.

Në Gjilan të rinjtë janë përdorues të mëdhenj të instagramit dhe të youtubes, ndërsa shumë pak e përdorin facebookun dhe aspak twitterin.

Në Mitrovicë, ngjashëm me Gjilanin, të rinjtë janë përdorues të mëdhenj të instagramit dhe të youtubes, aspak të facebookut dhe të twitterit.


Në Podujevë të rinjtë, në rend të parë, e përdorin instagramin, ndërsa si opSION shtesë e kanë shtuar edhe snapchatin. Ata njihen si përdorues të mëdhenj të snapchatit.

Të rinjtë e Gjakovës janë përdorues të instagramit dhe të facebookut. Ky i fundit është i dyti në përqindje.

Të rinjtë e Ferizajt janë paraqitur si përdorues të mëdhenj të twitterit dhe të youtubes.

6.7. Kategoria e njerëzve me të cilët komunikojmë më së shumti nëpërmjet rrjeteve sociale

7. Me cilat persona komunikoni më së shumti nëpërmjet këtyre rrjeteve:



Largësia ndërmjet njerëzve është një fakt që na ka bërë të qëndrojmë më shumë në rrjete sociale për ta ndier veten më afër me personat e zemrës dhe për të pasur mundësi komunikimi. Megjithatë, jo gjithmonë flasim me personat e afërt e të njohur me të cilët duhet të komunikojmë, ngase jo rrallë krijohet edhe ndonjë shoqëri e re, kryesisht me persona të cilët nuk i kemi takuar asnjëherë dhe që ndoshta nuk e meritojnë kohën tonë të çmueshme.

Të rinjtë e Prishtinës janë përgjigjur me shumicë se si kohën e tyre e kalojnë duke biseduar me shokë në rrjete sociale, ndërsa shumë më e vogël është përqindja sipas së cilës ata e kalojnë kohën e tyre të lirë duke biseduar me të afërmit dhe familjarët krahasuar me kohën që e kalojnë duke biseduar me shokët.

Po ashtu përqindje të lartë të kalimit të kohës duke biseduar me shokët e kanë dhënë edhe të rinjtë e Komunës së Prizrenit, ndërsa menjëherë pas kësaj ata janë deklaruar se flasin edhe me të afërmit dhe me familjarët e tyre përmes rrjeteve sociale. Kishte edhe prej tyre që flasin edhe me njerëz të cilët as nuk i kanë shoqëri dhe as nuk i kanë familje e të afërm, pra me persona krejtësisht të panjohur.

Të rinjtë e Gjilanit me shumicë të madhe janë përgjigjur se në rrjetet sociale flasin me shokët e tyre, ndërsa menjëherë pas shoqërisë ata kanë thënë se flasin edhe me të afërmit dhe familjarët e tyre. Një përqindje shumë e vogël flasin edhe me njerëz të panjohur.

Edhe të rinjtë e Mitrovicës janë të përkushtuar ndaj shoqërisë dhe shumë pak sish tyre flasin me familjarët e tyre.

Në Podujevë gjithashtu të rinjtë e saj kanë treguar se më shumë flasin me shoqërinë e tyre e në raste të rralla flasin edhe me familjarët dhe të afërmit, ndërsa përqindja më e vogël e tyre kanë treguar se ndonjëherë flasin edhe me njerëz të panjohur.

Të rinjtë e Gjakovës na janë paraqitur pothuajse me përqindje të njëjtë për të gjitha përgjigjet, ndërsa pak më shumë ata flasin me shokët, duke mos lënë anash familjen dhe të afërmit. Shqetësuese ishin përgjigjet e disa të rinjve të Gjakovës të cilët kanë thënë se flasin edhe me njerëz të panjohur.

Të rinjtë e Ferizajt flasin në rrjetet sociale me njerëz të tjerë të panjohur, të cilët nuk përfshihen as te shoqëria as te familja e të afërmit.

6.8. Ndikimi fizik dhe psikik i rrjeteve sociale

8. A mendoni që përdorimi i rrjeteve sociale ndikon negativisht në aspektin fizik dhe psikik tek ju:

Shërbeti

Gjinia

Kosovë

Djem


Vajza

Niveli

Shkollia filllore - Shkollia e mesme - Bachelor

Moshë

13 - 29 vjeç



1386 të anketuar

Përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale kushtëzon qëndrimin në një pozitë që është e dëmshme për ndonjë pjesë të trupit e ndonjëherë edhe për tërë trupin, gjë që mund të shkaktojë deformime fizike, dhe zhvillime të gabuara psikike.

Të rinjtë e Komunës së Prishtinës janë përgjigjur se tek ata rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak në aspektin fizik dhe psikik, kurse në përqindje të përafërt janë përgjigjur se rrjetet sociale në aspektin fizik dhe psikik ndikojnë mesatarisht në ta.

Ndërkohë në Prizren të rinjtë kanë dhënë përgjigje të ndryshme rreth kësaj çështjeje. Ata janë deklaruar se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë tek ata, por përafërt me këtë ka qenë edhe përgjigjja sipas së cilës rrjetet sociale në aspektin e tyre fizik dhe psikik ndikojnë shumë. Jo shumë larg kësaj ka qenë edhe përgjigjja sipas së cilës rrjetet sociale mesatarisht ndikojnë te ta.

Në Gjilan të rinjtë kanë dhënë përgjigje të dy skajeve. Disa kanë thënë se rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak në aspektin e tyre fizik dhe psikik, ndërsa disa të tjerë kanë thënë se rrjetet sociale ndikojnë shumë te ta në aspektin fizik dhe psikik.

Po ashtu edhe të rinjtë e Mitrovicës janë përgjigjur ngjashëm me ata të Gjilanit. Disa prej tyre kanë thënë se rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak te ta në aspektin fizik dhe psikik, ndërsa të tjerët kanë thënë se rrjetet sociale ndikojnë shumë te ta në aspektin e tyre fizik dhe psikik.

Të rinjtë në Podujevë konsiderojnë se rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak te ta në aspektin fizik dhe psikik, por ka pasur edhe një numër të konsiderueshëm të të rinjve të cilët janë shprehur se rrjetet sociale ndikojnë shumë te ta në aspektin fizik dhe psikik.

Të rinjtë e Gjakovës kanë thënë se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë te ta në aspektin fizik dhe psikik, por menjëherë pas kësaj përgjigjeje, me një përqindje të lartë vjen optionsi se rrjetet sociale ndikojnë shumë tek ata.

Të rinjtë e Ferizajt përsëri na kanë ardhur me përgjigjet e tyre të skajshme. Në përqindjen më të lartë ata thonë se rrjetet sociale ndonjëherë ndikojnë në jetën e tyre, kurse përgjigjja e dytë, me vetëm pak dallim, është se rrjetet sociale ndikojnë shumë në aspektin fizik dhe psikik të jetës së tyre.

7. KRAHASIMI NDËRMJET TRI NIVELE SHKOLLORE: FILLOR, I MESËM DHE BAÇELOR

1. Cila është arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale:


Shkollat fillore: Janë përgjigjur se, më së shumti, i përdorin rrjetet sociale për të kaluar kohën e lirë, ndërsa sa për studime dhe për t'u informuar vetëm një numër shumë i vogël prej tyre e konfirmojnë si mundësi. Arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale vetëm për kalimin e kohës së lirë në këto përmasa te të rinjtë që janë në shkolla fillore

ka të bëjë me faktin se ata nuk janë mirë të informuar për rreziqet të cilat mund të ballafaqohen në aspektin fizik e psikik dhe gjithashtu nuk janë të informuar për përdorimin në mënyrë racionale të rrjeteve sociale.

Shkollat e mesme: Të anketuarit kanë dhënë përgjigje të llojllojshme. Ata dukshëm më mirë e menaxhojnë kohën e tyre, duke e shfrytëzuar edhe për studime, pa e lënë anash as aspektin e argëtimit dhe kalimit të kohës së lirë.

Bachelor: Duke marrë parasysh edhe pozitën në të cilën gjenden të anketuarit, të cilët janë duke kryer studimet universitare, edhe përgjigjet janë përputhur me nivelin e tyre, pasi me shumicë janë përgjigjur se rrjetet sociale i përdorin për studime dhe për t'u informuar. Përgjigje kjo e kënaqshme për këta të rinj.

1. Cila është arsyeja e përdorimi të rrjeteve sociale:



2. A mendoni se koha që ju e kaloni në rrjetet sociale jua humb kohën me familje?

Shkollat fillore: Të rinjtë e shkollave filore mendojnë se rrjete sociale ndonjëherë ua humbin kohën e paraparë për ta kaluar me familjen. Shumë prej tyre gjithashtu janë përgjigjur të sigurt dhe me vetëdije të plotë se rrjete sociale ndikojnë në kohën e tyre, duke u përgjigjur me “Po”. Ndonëse përgjigjet nuk na pëlqyen, gjithsesi pranimi i gabimit është hapi i parë drejt përmirësimit.

Shkollat e mesme: Përgjigje pothuajse të njëjta kishin edhe të rinjtë e shkollave të mesme. Ata mendonin se rrjetet sociale ndikojnë ndonjëherë në humbjen e kohës të cilën e kalojnë me familjen e disa prej tyre, edhe pse në numër më të shumë, ishin përgjigjur me “Po”.

Bachelor: Ndërsa te studentët edhe pse kishte përgjigje me “Jo”, përsëri më të shumtë në numër ishin ata që u përgjigjën me opcionin se rrjetet sociale ndikojnë në humbjen e kohës të cilën do të mund ta kalonin me familjen.

Përgjigjet e tyre na bëjnë të mendojmë se vetëdijesimi nuk është i nevojshëm për këta të rinj për të filluar ndryshimin, por, në rastin tonë, kemi të bëjmë vetëm me rikujtim, në mënyrë që të ketë dobi te këta të rinj, të cilët tashmë veçse e kanë kuptuar se çka është e dëmshme dhe çka ndikon negativisht tek ata, por thjesht nuk kanë ndërmarrë hapa për të ndryshuar.

3. Sa orë në ditë i kaloni në rrjete sociale?


Shkollat fillore: Të anketuarit janë përgjigjur shumica e tyre që në rrjetet sociale i kalojnë 1-2 orë gjatë ditës, gjë e cila na jep përshtypje se tek kjo kategori e të rinjve ende ka mbikëqyrje të prindërve në përdorimin e rrjeteve sociale. Mirëpo nuk ishin edhe shumë të rralla rastet kur këta të rinj janë përgjigjur se rrjetet sociale i përdorin 2-3 orë, ndaj shikuar nga këndvështrimi i mesatares, vlerësojmë se këta të rinj janë përgjigjur me opcionet mesatare, duke mos shkuar në skajin e përdorimit të rrjeteve sociale me 4 orë e më shumë.

Shkollat e mesme: Të rinjtë e shkollave të mesme janë përgjigjur pothuajse në mënyrë të barabartë sa i përket përdorimit të rrjeteve sociale në kohëzgjatje prej 1-2 orë dhe 2-3 orë, duke arsyetuar me mendimin se janë më të rritur dhe se kanë nevojë t'i përdorin rrjetet sociale për informim dhe studime.

Bachelor: Shqetësuese ishin përgjigjet e studentëve, të cilët, edhe pse në përqindje shumë të madhe janë përgjigjur me 1-2 orë dhe 2-3 orë, në mesin e tyre kishte edhe të tillë (jo të paktë në numër) që rrjetet sociale i përdornin 4 orë e më shumë. Marrë parasysh faktin se disa prej tyre janë edhe studiues të shkencave kompjuterike, atëherë mund ta gjejmë zgjidhjen e përgjigjeve të tyre. Mirëpo, në anën tjetër, një numër tjetër i konsiderueshëm i studentëve duhet medoemos ta ndryshojnë sistemin e tyre të të jetuarit me

komputerin dhe botën e teknologjisë, pasi shumë shpejt do të kenë probleme të mëdha shëndetësore e jetësore.

3. Sa orë në ditë kaloni në rrjete sociale:




4. Sa jeni të varur nga rrjetet sociale dhe a keni provuar t'iu largoheni për një kohë?

Shkollat fillore: Të anketuarit janë përgjigjur se ndihen të varur dhe se kanë menduar të largohen shpeshherë, kurse disa prej tyre janë përgjigjur se ndihen të varur vetëm ndonjëherë. Këto janë përgjigjet më të shpeshta që i kemi marrë.

Shkollat e mesme: Përgjigje pothuajse të njëjta me nxënësit e shkollave fillore na kanë dhënë edhe nxënësit e shkollave të mesme, të cilët janë përgjigjur se ndihen të varur prej rrjeteve sociale dhe se kanë menduar të largohen prej tyre. Shumë prej tyre kanë thënë se ndihen të varur vetëm ndonjëherë.

Bachelor: Ndërkohë te studentët përgjigja më e shpeshtë ka qenë “nuk ndihem aq i/e varur nga rrjetet sociale”. Vetëm ndonjëherë këta të rinj e ndiejnë veten të varur nga rrjetet sociale, duke shtuar edhe raste të shpeshta kur ata janë përgjigjur se nuk ndihen të varur.

4. Sa jeni të varur nga rrjetet sociale, dhe a keni provuar t'iu largoheni për një kohë?




5. Sa ndikon përdorimi i rrjeteve sociale në jetën tuaj studentore dhe a ju pengon për moslexim?

Shkollat fillore: Përgjigjet e të anketuarve të shkollave fillore ishin se tek ata ndikon ndonjëherë përdorimi i rrjeteve sociale për studime dhe për moslexim, por nuk ishin të rralla edhe rastet kur kanë thënë se ndikojnë shumë dhe aspak. Pra, kemi gjetur një llojllojshmëri përgjigjesh.

Shkollat e mesme: Nxënësit e shkollave të mesme janë përgjigjur më së shpeshti se “mesatarisht rrjetet sociale ndikojnë në moslexim dhe në jetën e tyre studentore, duke mos lënë anash edhe një grup të atyre që kanë thënë se vetëm ndonjëherë ju ndodh që të ndikojnë rrjetet sociale në studime dhe moslexim, por jo gjithmonë.

Bachelor: Studentët na kanë dhënë përgjigjet më të shpeshta me “ndonjëherë”, shumë pak prej tyre janë përgjigjur se “rrjetet sociale nuk ndikojnë aspak në jetën e tyre të studimeve”. Përgjigjet e të gjitha grupmohave ishin të larmishme, por kjo ishte shumë shqetësuese, sepse edhe përkundër asaj që kemi parë më lart, ata janë përdorues të mëdhenj të rrjeteve sociale, në këtë përgjigje kanë dëshmuar se nuk janë të vetëdijshëm për pasojat dhe, në njëfarë mënyre, janë munduar t’iu largohen përgjegjësive duke u përgjigjur me opcionin “ndonjëherë”.

5. Sa ndikon perdorimi i rrjeteve sociale ne jeten tende studentore dhe a ju pengon per mos-lexim?




6. Cilin rrjet social e përdorni më së shumti?

Shkollat fillore: Në shkollat fillore më së shumti e përdorin instagamin dhe youtubenë, duke marrë parasysh moshën e nxënësve këto përgjigje edhe ishin të pritshme.


Shkollat e mesme: Për nxënësit e shkollave të mesme rrjeti social më i përdorur ishte instagami, pastaj facebooku dhe e treta vinte youtube.

Bachelor: Renditje të njëjtë, sikurse te të rinjtë e shkollave të mesme, kishte edhe për studentët në universitete që janë përgjigjur se më së shumti e përdorin instagamin, pastaj facebookun dhe në radhitje e treta ishte youtube.


6. Cilin rrjet social e përdorni më së shumti:



147 të anketuar



338 të anketuar



549 të anketuar


7. Me cilët persona komunikoni më së shumti nëpërmjet këtyre rrjeteve?

Shkollat fillore: Nxënësit e shkollave fillore janë përgjigjur se më së shumti komunikojnë me familjarët dhe me shokët.

Shkollat e mesme: Të anketuarit prej shkollave të mesme na janë përgjigjur se më së shumti komunikojnë me shokët dhe pak prej tyre edhe me familjarë dhe me të afërmit e tyre.

Bachelor: Studentët na janë përgjigjur se komunikojnë me shokët dhe me familjarët, ndërsa një grup i vogël i tyre janë përgjigjur se komunikojnë me të tjerë.

7. Me cilët persona komunikoni më së shumti nëpërmjet këtyre rrjeteve:



8. A mendoni që përdorimi i rrjeteve sociale ndikon negativisht në aspektin fizik dhe psikik të ju?


Shkollat fillore: Më së shumti na janë përgjigjur se nuk ndikon aspak te nxënësit e shkollave fillore.

Shkollat e mesme: Shumica e nxënësve të shkollave të mesme janë përgjigjur me opcionin “aspak”, por një grup tjetër i konsiderueshëm janë përgjigjur se përdorimi i rrjeteve sociale ndikon shumë në ta në aspektin fizik dhe psikik.

Bachelor: Studentët janë përgjigjur se rrjetet sociale ndikojnë mesatarisht tek ata në aspektin fizik dhe psikik. Një grup tjetër kanë thënë “aspak”, pa lënë anash as përgjigjen sipas së cilës rrjetet sociale ndikojnë shumë tek ata.

Duke e shikuar dhe duke e krahasuar moshën ndërmjet të rinjve, kemi vërejtur se sa më të rritur ishin respondentët aq më shumë ishin në dijeni për pasojat negative që u kanë sjellë rrjetet sociale atyre.

8. A mendoni që përdorimi i rrjeteve sociale ndikon negativisht në aspektin fizik dhe psikik tek ju:



Nga përgjigjet që i morëm shohim se, sipas grupmoshave, edhe të rinjtë janë të ndikuar prej rrjeteve sociale, gjegjësisht të anketuarit, të cilët ishin të shkollave fillore kanë dhënë përgjigje që janë në përputhje me moshën e tyre. Ndonëse një pjesë të kohës së tyre ende e kanë në mbikëqyrje prindërit, gjithsesi është vërejtur që edhe tek ata ka një dozë të tepruar të shfrytëzimit të rrjeteve sociale, në anën tjetër të rinjtë e shkollave të mesme dhe studentëve, të cilët studiojnë në bachelor, përshtaten me moshën, por shpeshherë është i tepruar në çdo aspekt përdorimi i rrjeteve sociale, gjë që na jep ndjenjën që të rinjtë çdo ditë e më shumë janë duke krijuar varshmëri, e rreziku më i madh i gjithë kësaj është se varshmëria mund të shndërrohet në sëmundje që nuk do të ketë mundësi të rehabilitohet edhe nëse angazhohemi me të gjitha forcat. Bazuar në rezultatet duhet të fillojmë me ndryshime që të mos bëhet vonë në këtë drejtim.

8. KUFIZIMET DHE REKOMANDIMET

Ishte një kënaqësi e veçantë që të merremi me këtë hulumtim shkencor, por gjatë rrugëtimit të hulumtimit kemi hasur edhe në gjëra që nuk kanë shkuar edhe aq mirë. Sidomos pritja e mirë në disa institucione nuk ka qenë në nivel, por gjithsesi kjo është tejkualuar me mirësjellje nga ana jonë, duke synuar përfundimin e punës.

Po ashtu nuk kemi hasur shumë në hulumtime të tilla, me temën e njëjtë që janë bërë në vendin tonë, gjë që e ka vështirësuar punën.

Ndërkaq, sa iu përket rekomandimeve, duke pasur parasysh se tema të cilën e punuam në këtë hulumtim është e një rëndësie të madhe dhe gjithashtu është shumë e gjerë, do të ishte mirë që në të ardhmen të bëheshin hulumtime lidhur me disa nëntema që hyjnë brenda kësaj teme. Për-pjekjet e tilla do ta pasuronin edhe më shumë këtë materie, sepse marrë parasysh faktin se ne jemi fokusuar në një aspekt, mendojmë që kjo temë mund të trajtohet edhe nga aspekte të tjera.

Do të ishte mirë që të shkruhej në veçanti dhe të trajtoheshin më hollësi problemet që tashmë i kanë shkaktuar rrjetet sociale, si në aspektin psikik tek të rinjtë, duke marrë edhe shembuj të ndryshëm të të rinjve të cilët tashmë janë viktimat e rrjeteve sociale.

Pastaj do të ishte mirë që ta trajtojmë edhe temën e ndikimit të rrjeteve sociale në aspektin fizik, duke sjellë edhe shembuj të deformimeve që kanë ndodhur si pasojë e përdorimit të telefonave dhe kompjuterëve në mënyrë të pakontrolluar.

Një hulumtim shumë i rëndësishëm do të ishte nëse do të përmbledheshin të gjitha këshillat për të ndryshuar jetën e një të riu, duke e transformuar prej jetës së tij teknologjike, në jetën reale gjithsesi të shoqëruar me teknologjinë, por në mënyrë racionale. Ky hulumtim do të mund të arri-

hej nëse do të bisedohej me ekspertë të psikologjisë, mjekë që merren me personat që kanë krijuar varshmëri të caktuar, duke përfshirë këtu edhe institucione që merren me edukimin e të rinjve, ngase përvojat e tyre edukative do të na ndihmonin shumë.

Hulumtim i një rëndësie të veçantë do të ishte edhe trajtimi i të ashtuquajturit “pseudoautizëm” që është bërë dukuri shumë e përhapur te fëmijët.

Gjithnjë lidhur me fëmijët do të ishte mirë të bëhej një hulumtim nëse fëmijët e mësojnë gjuhën dhe edukatën prej telefonit apo prej familjes?! Kjo sidomos për faktin se shumë prej fëmijëve sot kanë filluar të flasin gjuhën e programeve që i shikojnë në telefon, televizor e kompjuter më me përparësi kundruall gjuhës së tyre amtare.

9. PËRFUNDIMI

Përdorimi i rrjeteve sociale nga të rinjtë e të gjitha rajeve të Kosovës, veçanërisht tek ata të moshës adoleshente, bazuar në teoritë dhe statistikat paraprake, na ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi varësinë e madhe që kanë nga rrjetet sociale, pa marrë parasysh qëllimet dhe arsyetimet.

Bazuar në një përqindje të madhe, opinionet më të shpeshta të respondentëve të këtij hulumtimi janë:

- shumica e tyre pohojnë se e kalojnë kohën e lirë në rrjete sociale dhe për shkaqe informimi;
- se shumica e tyre kanë provuar të shkëputen;
- se përdorimi i tepruar i rrjeteve sociale ndikon, në përqindje të konsiderueshme, negativisht në aspektin fizik dhe psikik;
- se ndonjëherë ndikon negativisht sa i përket leximit apo studimit dhe
- se më së shumti nëpërmjet këtyre rrjeteve kontaktojnë me shoqërinë e tyre.

Nga ky këndvështrim kuptojmë se, varësinë nga rrjetet sociale shumica prej tyre nuk e konsiderojnë problematike dhe as që janë të informuar mbi dëmet apo rreziqet e mundshme të aspektit fizik dhe psikik.

Megjithatë, ndikimi i rrjeteve sociale është bërë një trend që ka përfshirë masivisht gjithë njerëzimin. Ashtu, siç e cek një gjë të tillë edhe një nga mendimtarët me re-

nome botërore Malcom X, si dhe ish-aktivisti i të drejtave të njeriut, i cili thekson:

“Mediat janë një nga lidhjet më të fuqishme në botë. Ato kanë fuqinë ta paraqesin të pafajshmin fajtor dhe anashjelltas, dhe kjo quhet fuqi. Sepse ato kontrollojnë mendjet e masës.”

Si mendoni, a duhet të ketë ndonjë zgjidhje që na mundëson t’i kontrollojmë ne mediat sociale dhe mos të lejojmë që ato të na kontrollojnë ne?

Sigurisht se me vullnet të përbashkët dhe me bashkëpunim të vazhdueshëm, duke u mbështetur dhe këshilluar gjithnjë nga kompetentët dhe profesionalistët e këtyre fushave, do të mundohemi që t’i shërbejmë shoqërisë sonë me kontribute që janë në dobi të tyre dhe në interes të gjithë shoqërisë sonë.

Ne, si studentë të Fakultetit të Studimeve Islame, jemi angazhuar sadopak të japim një ndihmesë, bazuar në temën në fjalë, për të parë se çfarë mendojnë të rinjtë tanë dhe sa janë të vetëdijesuar mbi dëmet apo dobite që na sjellin rrjetet sociale në përditshmërinë tonë.

BIBLIOGRAFIA

1. ASATIANI, Sandro, "Mediat sociale në shkollë", Sandro's Books, 2011
2. AL-DEEN, Hana S.Noor & HENDRICKS, John Allen, "Social Media" (edited), Lexington Books, 2013
3. OCHS, Josh,"Light, Bright and Polite", MediaLeaders, 2015
4. VALKENBURG, Patti M. & PIOTROËSKI, Jessica Taylor, "Plugged in", Yale University Press, 2017
5. KEEN, Andrew, "The Internet is not the answer", Publishers Group West, NY, 2015
6. MENSAH, Sandra Okyeadie, "The impact of social media on students' academic performance- a case of Malaysia tertiary institution, Research Paper
7. MOWAFY, Gina, "The effects of social media on the academic performance of Nile University students", The American University in Cairo, Spring, 2018

APENDIKSI

Pyetësi:

Ndikimi i rrjeteve sociale në jetën e të rinjve

Emri _____

Gjinia _____

Mosha _____

Vendi _____

Anketë nga grupi hulumtues i studentëve të Fakultetit të Studimeve Islame – Prishtinë

1. Cila është arsyeja e përdorimit të rrjeteve sociale?

- a. për studime
- b. për argëtim
- c. për tu informuar
- d. për të kaluar kohën e lirë

*2. A mendoni që koha që ju kaloni në rrjetet sociale, ju
humb kohën që duhet të kaloni me familjen tuaj?*

- a. Po
- b. Jo
- c. Ndonjëherë

3. *Sa orë në ditë kaloni në rrjete sociale?*
- a. më pak se 1 orë
 - b. 1 - 2 orë
 - c. 2 - 3 orë
 - d. 4 orë e më shumë
4. *Sa jeni të varur nga rrjetet sociale, dhe a keni provuar t'iu largoheni për një kohë?*
- a. Ndihem i varur, dhe nuk kam menduar të largohem
 - b. Ndihem i varur dhe kam menduar të largohem shpeshherë
 - c. Nuk ndihem aq i varur, vetëm ndonjëherë
 - d. Nuk ndihem i varur
5. *Sa ndikon përdorimi i rrjeteve sociale në jetën tënde studentore dhe a ju pengon për moslexim?*
- a. Aspak.
 - b. Mesatarisht.
 - c. Shumë.
 - d. Ndonjëherë
6. *Cilin rrjet social e përdorni më së shumti?*
- a. Facebook
 - b. Instagram
 - c. Twitter
 - d. Youtube

7. *Me cilët persona komunikoni më së shumti nëpërmjet këtyre rrjeteve?*
- a. familjen
 - b. shokët
 - c. të afërmit
 - d. të tjerë
8. *A mendoni që përdorimi i tepërt i rrjeteve sociale ndikon negativisht në aspektin fizik dhe psikik tek ju?*
- a. Po
 - b. Jo
 - c. Ndoshta
 - d. Nuk e di

*Prishtinë,
Janar 2020*